

I mbajtur me rastin e takimit të 7 (shtatë) të rregullt për vitin 2024 të Komunitetit për Komunitetet, mbajtur me datë 16.07.2024 duke filluar nga ora 9:00.

Rend dite

1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

3.Informatë për aktivitetet e KKSB-së për periudhën janar-qershor 2024;

4.Të ndryshme;

Takimin e hapi kryesuesi i komisionit Denis Sofra dhe i njoftoi me rendin e ditës.E hedh në votim rendin e ditës.

Aprovohet rendi i ditës

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Denis Sofra - e hedh në votim pikën 1.

Aprovohet pika 1

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime dhe thotë që para dy seancave është marrë vendimi për dhënie në shfrytëzim për 4 banesat e komunës dhe sipas ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme kërkohet që të formohet komisioni për vlerësimin e ofertave dhe udhëheqjen e procedurave për dhënie në shfrytëzim të këtyre banesave.

Denis Sofra - hap debatin.Pasi nuk ka debat e hedh në votim pikën 2.

Aprovohet pika 2

Pika 3. Informatë për aktivitetet e KKSB-së për periudhën janar-qershor 2024;

Avni Bytyqi - KKSB-ja ka për obligim që për 6 mujorin e parë dhe 6 mujorin e dytë ta informoj Kuvendin dhe komitetet obligative me çështjen e punës dhe aktivitetet që i ka ndërmarrë ky këshill.Zyrtari ligjor tutje jep sqarime sa i përket kësaj pike.

Denis Sofra - hap debatin.Pasi nuk ka debat e hedh në votim pikën 3.

Aprovohet pika 3

Pika 4. Të ndryshme

Denis Sofra - dua ti njoftoj të pranishmit për një projekt që është duke e bë nga Ministria e Financave,Punëve dhe Transfereve. Projekti është:Reforma e asistencës sociale.Projekti në fjalë është aktual por që kanë ndryshu disa kriteret.Denis Sofra jep sqarime rreth ndryshimit të këtyre kriterëve dhe thotë që projekti po vazhdon në regjione dhe këtë javë pritet të mbahet në regjionin e Prizrenit ku do të ftohen zyrtarët e Qendrës sociale dhe komunitet në përgjithësi.Jeni të lirë me marrë pjesë. Aplikimet po vazhdojnë dhe nga komuna e Suharekës janë mbi 1300 familje që kanë apliku për këtë skemë.

Denis Sofra tutje jep sqarime sa i përket këtij projekti.

Takimi përfundoi: 09:15